

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **626-26-7168-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Kubezimi i rrugeve lokale ne territorin e Mamushes Faza e II - Lot 1ruget Haziran Segmenti 1 dhe 2,Rruga Celik dhe rruga Hanimeli , Lot 2 Rruget Karanfil, Rruget Yever dhe Cumhuryet segment**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	VEH CONSTRUCTION SH.P.K.
NUI	812158336
Adresa	Rr. Brigada 123
Vendi	Suhareke
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+383 49603550
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	VEHBI MAMAJ
Adresa elektronike	vehconstructionsphpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Kubezimi i rrugeve lokale ne territorin e Mamushes Pjesa II Lot 1lot 1 = PROJEKTI KRYESOR KUBËZIMI I RRUGËVE LOKALE NË TERRITORIN E MAMUSHËS rruget Haziran Segmenti 1 dhe 2,Rruga Celik dhe rruga Hanimeli Kubezimi i rrugeve lokale ne territorin e Mamushes Pjesa II -Lot 2LOT 2= PROJEKTI KRYESOR KUBËZIMI I RRUGËVE LOKALE NË TERRITORIN E MAMUSHËS Rruget Karanfil, Rruget Yever dhe Cumhuryiet segment

Kubezimi i rrugeve lokale ne territorin e Mamushes Faza e II -Lot 1rruget Haziran Segmenti 1 dhe 2,Rruga Celik dhe rruga Hanimeli , dhe Lot 2 Rruget Karanfil, Rruget Yever dhe Cumhuryiet segment

Njoftimi për kontratë: 04.09.2026

Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje: 21.09.2026 14:00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesë për rishqyrtim të kriterëve:13.09.2026 10:47

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), Nenet:

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-se

dhe

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar),

Nenet:

Neni 17 - Dosja e Tenderit

Neni 19 - Specifikimet Teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit, ne si OE - palë e interesuar për pjesëmarrje në këtë tender, kemi vërejtur se AK ka vendosur kushte dhe kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-042 - PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (LPP tani e tutje), I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, (Versioni i Konsoliduar) e Neneve 1, 7 dhe 28, si dhe RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (RRPP tani e tutje) (Versioni i Konsoliduar), e Neneve 17 dhe 19.

Pretendimi 1

AK në Dosjen e Tenderit ka vendosur kriter që nuk është në pajtim me LPP-në dhe me RRPP-në. Kriteri: Kapaciteti teknik dhe profesional; Nr. i Nenit: 9.1&9.2; Kërkesat

minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Kërkesa 2 - OE duhet të ketë staf profesional si, kriteret:

-Nje (1) specialist per siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri .

- O.E duhet te kete min 5 (pese) punetor te paisur me certifikata te vlereshme per ndihmen e pare dhe mbrojtje nga zjarri

Sipas konstatimit të parë, Kapaciteti teknik dhe profesional në Njoftimin për Kontratë Neni III.2.4 dhe në Dosjen e Tenderit Neni 9.1 & 9.2 ndër të tjera janë kërkuar gjithsej 6 (gjashtë) Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe Mbrojtje nga Zjarri. Lidhur me Certifikime për siguri dhe shëndet në punë si dhe mbrojtje nga zjarri, kërkesa për posedim të Certifikatës të rishqyrtohet dhe të harmonizohet me dispozitat e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë Ligji Nr.04/L-161 në veçanti me Nenin 9, 10 dhe 11, të cilat përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit për organizimin dhe zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Nga këto dispozita rezulton se përgjegjësia për sigurimin e personave kompetent dhe zbatimin e masave të sigurisë i takon punëdhënësit, ndërsa ligji nuk kërkon që disa anëtar të stafit teknik të jetë të pajisur individualisht me certifikatë për Siguri dhe Shëndet në Punë. Për këtë arsye, kërkesa që një profil specifik profesional (p.sh. inxhinier hidroteknik, ndërtimor, mekanik, elektrik, etj.) të posedojë detyrimisht këtë certifikatë është jo proporcionale dhe kufizuese për konkurrencën dhe në kundërshtim me Nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së. Nëse ju si Autoriteti Kontraktues e konsideroni të domosdoshme posedimin e kësaj Certifikate, rekomandojmë që ajo të kërkohej në emër të Operatorit Ekonomik, duke lejuar që certifikata të posedohet nga personi kompetent i angazhuar nga Operatori Ekonomik për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi, e jo domosdoshmërisht nga 5 punëtorët për një pozitë ose profil të caktuar.

Këto kritere janë diskriminuese dhe e kufizon pjesëmarrjen e shumë OE në këtë tender duke e favorizuar një kompani të caktuar. Ju lutem ti largoni ose ti ndryshoni këto kritere që të na mundësohet pjesëmarrja në këtë tender. Kërkojmë që 5 (pese) punetor te paisur me certifikata te vlereshme per ndihmen e pare dhe mbrojtje nga zjarri të largohet si kriter.

Pretendimi 2

AK në Dosjen e Tenderit ka vendosur kriter që nuk është në pajtim me LPP-në dhe me RRPP-në. Kriteri: Kapaciteti teknik dhe profesional; Nr. i Nenit: 9.1&9.2; Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Paisjet e nevojshme për kryerjen e këtij aktiviteti OE duhet të ketë, kriteret:

Pajisjet:

Për pajisjet:

- Cilinder Gome -Hekur me xhemba dhe shtytese para me peshe maksimale 2.100 kg.....cope 2.

-Rul cilinder kombinues gome-hekur me pesh operative max 2.3 toncope 1

-Rul hekur-hekur me peshe operative 2.3 toncope 1

-Cilinder Vibrues min 12 toncope 1

Ju si Autoritet Kontraktues nuk jeni përgjigj në kërkesën për sqarim të datës

02.09.2026 se: çka nënkuptoni me peshë operative? Nëse është e caktuar pesha

operative, cila është pesha totale e pajisjes? Pse janë kërkuar katër lloje pajisjesh për ngjeshje (duke përfshi dhe Një cilinder vibrues min 12 ton), për të njëjtin pozicion të punimeve? A ekziston ndonjë pozicion që justifikon përdorimin e katër llojeve të pajisjeve të ndryshme për ngjeshje? Pse një cilinder vibrues min. 12 ton që është kërkuar si kriter nuk mund ta kryej punën e këtyre cilindrave dhe rulave si më sipër? Në përgjithësi përse përdoren këto rula/cilindra, për ngjeshje të asfaltit apo

për ngjeshje të shtresave gurore? Është mëse e qartë se këto rula – cilindra përdoren për ngjeshjen e shtresave të asfaltit e që nuk kanë të bëjnë fare me këtë tender sepse nuk ka asnjë m. asfalt. Gjithashtu kjo tregon mungesë të analizës teknike dhe e bën kriterin joproporcional. Kriteret për plotësim për këto lloje të makinerisë favorizojn një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem ti largoni këto kritere.

Për pajisjen:

-Kamion për Pastrim të rrugëve për pesha ngarkuese e lejuar max 4800 kgcope 2
Ku duhet të përdoret kjo pajisje, në cilin pozicion të paramasës? Pse është kufizuar pesha bartëse në max. 4800 kg? Pse uji duhet të matet me kg e jo me litra? Kriteri për plotësim për këtë lloj të pajisjes specifike favorizojn një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem t'a largoni këtë kriter.

Për pajisjet:

- Dy kamion kipër me peshe bartëse të ngarkese se lejuar min 23 ton.
Pse kërkohet pikërisht minimumi 23 ton? Pse katër kamion me peshë bartëse min 16 ton nuk do të ishin të aftë të realizonin të njëjtat punime? Në cilin pozicion të projektit mbështetet ky kufizim? Cili dokument teknik e rekomandon këtë peshë? A mund të përdoren dhe kamionët Kokë Tërheqëse me Rimorkio kipër? Nëse jo pse? Ju si Autoritet Kontraktues nuk jeni përgjigj në kërkesën për sqarim të datës 02.09.2026. Pesha specifike bartëse të ngarkese se lejuar min 23 ton e favorizon një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem t'a zbritni peshën e ngarkesës së lejuar nga 23 ton në 16 ton siq kërkohet zakonisht. Ju si AK keni hartuar specifitime teknike për këtë makineri që favorizojn një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem ta ndryshoni peshën bartëse të ngarkese se lejuar nga min 23 ton në min 16 ton, dhe të shtohen nga dy në katër kamion kipër.

Për pajisjet:

-Koke tërheqëse min 26 ton.....cope

Në kërkesën për sqarim ju si Autoritet Kontraktues nuk e keni sqaruar se a i referoheni peshës totale të pajisjes apo peshës bartëse. Paqartësia e këtij kriteri krijon pasiguri juridike dhe mundëson interpretime të ndryshme gjatë fazës së ofertimit dhe vlerësimit të ofertave, duke cenuar parimin e transparencës dhe të trajtimit të barabartë.

Për pajisjen:

-Skraper minimum 16 ton.....cope 1

Në sqarimin e datës 03.09.2026 ju si AK keni sqaruar se pajisja Skraper “është një makinë që gërmon dheun, asfaltin dhe pjesë tjera të rrugëve e mbledh materialin në kovën”.

Fillimisht ju sqaroj se (gjatë hulumtimit në literaturë pasi që ju keni kërkuar), kjo pajisje SKRAPER fare nuk përdoret për gërmime dheu – përdoret ekskavatori, fare nuk përdoret për gërmime asfalti (siq ju e keni shpjeguar) – përdoret grryesja e asfaltit (Ëirtgen).

Shpjegim: Skraperi, në inxhinieri, është një makineri për zhvendosjen e dheut në distanca të shkurtra (deri në rreth 3 km) mbi terrene relativisht të sheshta. I pajisur me motor ose i tërhequr, ai përbëhet nga një arkë me një portë dhe një teh në pjesën e poshtme. Tehu gërryen dheun ndërsa arka shtyhet përpara, duke e detyruar dheun të hyjë brenda saj. Kur arka mbushet, dera mbyllet dhe materiali transportohet në vendin e shkarkimit. Skraperi është pajisja që përdoret ekskluzivisht në ndërtimin e autostradave.

Ju si Autoriteti Kontraktues nuk keni shpjeguar se pse një makineri e kësaj kategorie është për plotësim kriteri. Kjo tregon mungesë të analizës teknike dhe e bën kriterin joproporcional. Kriteri për plotësim për këtë makineri favorizojn një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem ta largoni këtë kriter.

Për pajisjen:

-Gjysemrimorkio per sinalizimte punimeve ne punen, e paisur me shenja trafiku , trupa ndriquesme motor me peshe bartese maksimum 500 kgcope 1

Ju si Autoritet Kontraktues nuk jeni përgjigj në kërkesën për sqarim të datës 02.09.2026 se: Ku duhet të vendoset kjo gjysemrimorkio per sinjalizime? Pse pajisjet “Semafor te pavarur me menaxhim te trafikut gjate bllokimit te shiritave qarkulluescope 2 (siq kërkohet për plotësim kriteri)” nuk mund ta rregullojnë komunikacionin por duhet pajisje shtese? A mund ta përshkruani rolin e motorit në këtë pajisje?

Ju si AK keni hartuar specifikime teknike për këtë makineri që favorizon një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem ta largoni këtë kriter.

Për pajisjen:

• Greder max 12 tonecope 2

Pse është kërkuar pesha max 12 ton dhe jo min 12 ton siç kërkohet zakonisht? Pse është dallimi kaq i madh i peshave të pajisjeve: eskavator 55 ton min (pastaj është zbrit në 30 ton), Grejder max 12 ton, 4 valaka me peshe deri 2.3 ton? A jeni duke e favorizuar ndonjë kompani të caktuar me këto specifikime të pajisjeve? Vendosja e këtij kriteri për plotësim tregon mungesë të analizës teknike dhe e bën kriterin joproporcional. Kriteri për plotësim për këtë makineri favorizon një kompani të caktuar dhe që diskriminon një ose më shumë operatorë ekonomik. Ju lutem ta ndryshoni këtë kriter nga max 12 ton në min 12 ton.

Përmbledhje

Ju si AK në përgjigjen për sqarim keni specifikuar se “Pajisjet e kërkuara janë përcaktuar mbi bazën e analizës së punimeve të parapara në paramasë dhe specifikimeve teknike të projektit.”, për të gjitha pajisjet. Disa pajisje sic i përshkruam më lartë, nuk kanë të bëjnë fare me këtë projekt dhe nuk kanë asnjë punim të paraparë në paramasë.

Bazuar në Paragrafin 2 të Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së, citoj: “2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.”

Gjithashtu,

Bazuar në Paragrafin 3 të po të njëjtit Nen, citoj:

“3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet

që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.”

Gjithashtu,

Konform paragrafit 2 të Neni 28 - Specifikimet teknike, të LPP-se , citoj:

“2. Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.”

Gjithashtu,

Bazuar në Paragrafin 17.17 të Neni 17 - Dosja e Tenderit, të RRPP-së, citoj:

“17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.”

Gjithashtu,

Bazuar në paragrafin 19.16 të Neni 19 - Specifikimet Teknike, të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), citoj:

“19.16 ZKA do ta emërojë një person/ekip nga Njësia Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, për hartimin e specifikimeve teknike. Personi/ekipi i emëruar së bashku me Specifikimet teknike do të plotësojë dhe dorëzojë një Deklaratë nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, ku deklaron që specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik dhe që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Në rast që specifikimet teknike hartohen nga kompani të kontraktuara, Deklarata nën betim do të nënshkruhet nga kontraktori. Në rast se specifikimet teknike hartohen nga një ekspert i jashtëm, Deklarata nën betim duhet të nënshkruhet nga eksperti i jashtëm. Kurdo që eksperti i jashtëm mund të sigurohet nga ndonjë autoritet tjetër kontraktues, angazhimi i ekspertit të tillë do të sigurohet me aprovim në mes të dy ZKA-ve.”

Bazuar në të lartecukurat AK ka vendosur kërkesa që janë në kundërshtim me LPP-në dhe RRPP-në si dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues (ZKA) ka përgaditur specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Përfundim

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vendosur një numër të konsiderueshëm

kriteresh teknike dhe profesionale që nuk janë arsyetuar me asnjë analizë teknike apo profesionale dhe që tejkalojnë nevojat reale të kontratës.

Duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga AK që ta rishqyrtoni këtë kërkesë sepse është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), konkretisht e:

Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), Nenet:

Neni 7 i LPP-se

Neni 28 i LPP-se

dhe

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar), Nenet:

Neni 17 - Dosja e Tenderit

Neni 19 - Specifikimet Teknike

Pretendimi ynë është i bazuar në dëshmi dhe fakte të cilat lehtësisht mund të verifikohen, dëshmi të cilat i potencuam edhe më lartë, prandaj kërkojmë që NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES B58 i këtij tenderi të anulohet dhe të aprovohet kërkesa jonë për rishqyrtim. Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga ju që të shqyrtoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim në mënyrë meritore dhe të nxjerrni këtë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE VEH CONSTRUCTION SH.P.K., dhe të korrigjohen kriteret diskriminuese sipas kërkesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojmë që kemi bërë shpenzime materiale për përgatitjen e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe ankesën pranë OSHP-së

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*

- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*